



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - RepublicofKosovo



Kuvendi i Kryeqytetit  
Skupština Glavnog Grada -Municipality of Prishtina

## E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 6.10.2023,  
duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Pëllumb Bajçinovci, kryesues i KPF-së, anëtarët e KPF-së: Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Leutrim Retkoceri, Shegë Beqiri, Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi dhe Mirsad Vitia.

Mungoi: Bahri Gashi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Osman Bllaca, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Florim Krasniq, përfaqësues nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Pëllumb Bajçinovci, kryesues i komitetit.  
Kryesuesi propozoi këtë

### REND DITE :

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së gjashtë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Raporti i Kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronave komunale për gjashtëmuajrin e parë të vitit 2023;
3. Propozim-vendimi për arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës për realizimin e projektit të ngrohjes diellore " Solar4Kosovo " dhe realizimin e projekteve që dalin nga marrëveshja për realizimin e projektit të ngrohjes diellore "Solar4Kosovo" ;
4. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për botimin e librit "Shqipëria një histori në harta";

Faqe1nga10

5. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Redon (Nuredin) Bajramit;
6. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Afrim (Zenel) Memetit, Jakup (Ejup) Ismailit, Bajram (Ibish) Gashit dhe Jahi (Mejdi) Ramadanit;
7. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Shyhere (Fazli) Ramës dhe Flamur (Fehmi ) Ramës;
8. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Bahri (Rifat) Hoxhës dhe Besnik (Halit)Asllanit;
9. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Adem (Hazir) Berishës, Hetem (Hazir) Berishës, Fadil (Hazir) Berishës dhe Rrustem (Hazir) Berishës;
10. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Qamil (Ismet) Bullatovcit, Agron (Ismet) Bullatovcit, Bajram (Muharrem) Bullatovcit dhe Bujar (Muharrem) Bullatovcit;
11. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Besim (Lika) Namanit, Naim (Isa) Berishës, Idriz (Halit) Blakçorit, Arsim (Esat ) Blakçorit, Hajdin (Izmi) Berishës, Zenel (Izmi) Berishës, Zymer (Izmi) Berishës, Ilmi (Izmi) Berishës, Shaqir (Salih) Eminit, Milot (Isuf) Berishës, Fitim (Izmi) Berishës, Hatixhe (Bajram) Oranit, Neron (Isuf) Berishës, Alban (Feriz) Blakçorit, Florim (Omer) Gashit, Ilir (Omer) Gashit, Nazife (Bajram) Namanit dhe Shefkije (Bajram) Blakqorit;
12. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore "Pranvera shqiptare '81";
13. Të ndryshme.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, **Doruntinë Maloku**, drejtore e Drejtorisë së Pronës, propozoi që pika e 7-të e rendit të ditës të tërhiqet nga rendi i ditës, për shkak se në propozim-vendimin e parcelës nuk është cekur sipërfaqja në m<sup>2</sup> të parcelës komunale.

**Nora Kelmendi** pyeti se a do ta sillni në Kuvend të hënën apo po e tërhiqni edhe nga Kuvendi. **Doruntinë Maloku**, theksoi se do ta tërheqim nga kjo seancë.

**Izet Sadiku**, drejtor, propozoi që të futet në rend të ditës pika "**Informatë për gjendjen në institucionet shëndetësore ( QKMF, QMU, QMF)**".

**Pëllumb Bajçinovci**, kryesues, tha se nuk është këtu askush nga Drejtoria e Arsimit, për arsyet se kanë ardhur dy kërkesa për t'u futur në rend të ditës pikat: "**Informatë lidhur me përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2023-2024**" dhe "**Propozim-vendimi për caktimin e**

**komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukativosimore dhe aftësuese në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës.**

**Leutrim Retkoceri** theksoi se drejtoresha ka një takim, por pritet të vije shumë shpejt për t'i arsyetuar propozimet.

**Jeta Rafuna** kërkoi që pika e 12-të të zhvendoset si pikë e parë pas ekstraktit.

**Pëllumb Bajçinovci, kryesues** tha se pika e 12-të ka të bëj me **Propozim-vendimin për caktimin e lokacionit për vendosjen e Pllakës përkujtimore "Pranvera shqiptare '81"**, e që po kërkohet të vendoset si pikë e parë pas ekstraktit.

Po ashtu, tha se është një propozim-vendim që ka ardhur në fund për ndarjen e mjeteve financiare për Kolegjin e Kirurgëve të Kosovës, që të futet në rend të ditës.

**Valbona Makolli, drejtore**, dha sqarime lidhur me këtë propozim-vendim, duke thënë se Kolegjumi i Kirurgëve të Kosovës e ka paraqitur një kërkësë, e që ka të bëjë me një kongres treditor, në muajin tetor, ku merr pjesë edhe niveli qendror, por edhe mjekët tanë nga QMF dhe QMU, kanë kërkuar një përkrahje. Kryetari deshi ta përkrahë këtë koleg me 4500 euro.

**Pëllumb Bajçinovci, kryesues**, kërkoi nga drejtoresha ta lexojë titullin e propozim-vendimit dhe arsyetimin, pastaj të shpërndahet materiali.

Po ashtu, tha se pasi që nuk kemi diskutime të tjera po vazhdojmë, po shkojmë me rend dhe po i propozojmë këto pikat e reja, që të futen si pika të rendit të ditës dhe tërheqjen e pikave.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e Doruntinë Malokut, që të tërhiqet nga rendi i ditës "**Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Shyhrete (Fazli) Ramës dhe Flamur (Fehmi) Ramës.**

**Kryesuesi konstatoi se më 6 vota për dhe 4 nuk morën pjesë në votim, u miratua propozimi i Doruntinë Malokut, që të tërhiqet pika e 7 nga rendi i ditës.**

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e Jeta Rafunës, që të zhvendoset si pikë e dytë e rendit të ditës "**Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore "Pranvera shqiptare '81".**

**Kryesuesi konstatoi se më 6 vota për dhe 4 nuk morën pjesë në votim, u miratua propozimi i Jeta Rafunës, që të zhvendoset si pikë e dytë e rendit të ditës.**

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e Izet Sadikut, që të futet në rend të ditës pika "**Informatë për gjendjen në institucionet shëndetësore ( QKMF, QMU, QMF)**".

**Kryesuesi konstatoi se më 6 vota për dhe 4 nuk morën pjesë në votim, u miratua propozimi i Izet Sadikut, që të futet në rend të ditës pika "**Informatë për gjendjen në institucionet shëndetësore ( QKMF, QMU, QMF)**".**

**Kryesuesi tha se propozimi i radhës që të futet në rend të ditës është edhe pika "Propozim-vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Kolegin e Kirurgëve të Kosovës".**

**Leutrim Retkoceri**, sa i përket pikës së katërt "Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për botimin e librit "Shqipëria një histori në harta"" dhe "Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Kolegin e Kirurgëve të Kosovës", shprehu mendimin se të dy pikët nuk duhet të jenë për këtë seancë. Arsyetimi është që raportin e TM 2 dhe TM 3, besoj që ka nevojë të informohet Kuvendi pikë së pari për çështjen e financave dhe raportit finanziar të Komunës, pastaj të vazhdojmë, andaj mendoj që edhe pika e 4-të edhe kjo pikë të shtyhen deri në seancën kur të kemi gati një informatë të paktën për çështjen e raporteve financiare se ku jemi si Komunë.

**Valbona Makolli** u shpreh se sa për informimin e kolegëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, TM 2 është i publikuar në ueb-faqen e Komunës, për arsyse se nuk guxojmë ta kalojmë afatin që është i caktuar me ligj, kështu që siç jemi dakorduar, në fund të muajit do të jetë një seancë që do të mund ta sjellim edhe TM 2, dhe arsyjeja se pse TM 3 nuk ka ardhur në këtë seancë, është sepse jemi duke raportuar për periudhën që ka përfunduar të premten dhe për 9 ditë është kohë e pamjaftueshme për ta bërë një raport.

**Leutrim Retkoceri** theksoi se për informatën që na e dhatë unë sot u njoftova nga ana juaj, të falënderoj për këtë, mirëpo për neve ka qenë e nevojshme që ta kemi para mbledhjes së Kuvendit.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e Leutrim Retkocerit, që shtyhet për seancën e rradhës, "Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për botimin e librit "Shqipëria një histori në harta".

**Kryesuesi** konstatoi se më 6 vota për dhe 4 nuk morën pjesë, Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për botimin e librit "Shqipëria një histori në harta", tërhiqet nga rendi i ditës.

**Kryesuesi** tha se e kishim edhe "Propozim-vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për Kolegin e Kirurgëve të Kosovës" që të futet si pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi** konstatoi se kjo pikë nuk futet në rendin e ditës.

Po ashtu, janë edhe dy propozim-vendime nga Drejtoria e Arsimit që të futen rend dite, mirëpo këtu nuk e kemi drejtoreshën të na japë arsyetimet e vendimeve. Nëse jeni dakord i votojmë.

**Kryesuesi** e hodhi në votim që të futet në rend dite **Informata lidhur me përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2023 - 2024**.

**Kryesuesi** konstatoi se më 6 vota për dhe 4 nuk morën pjesë në votim, **Informata lidhur me përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2023 -2024**, futet në rend dite.

**Kryesuesi:** - e hodhi në votim që të futet në rend dite "Propozim – vendim për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës.

Kryesuesi konstatoi se më 6 vota për dhe 4 nuk morën pjesë në votim, Propozim-vendimi për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, futet në rend dite.

Me ndryshimet e bëra me futjen e tri pikave të reja në rend dite, me tërheqjen e dy pikave dhe zhvendosjen e një pike të rendit të ditës, Kryesuesi konstatoi se u miratua ky

#### REND DITE:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së gjashtë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore "Pranvera shqiptare '81";
3. Raporti i Kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronave komunale për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023;
4. Propozim-vendimi për arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës për realizimin e projektit të ngrohjes diellore "Solar4Kosovo" dhe realizimin e projekteve që dalin nga Marrëveshja për realizimin e projektit të ngrohjes diellore "Solar4Kosovo";
5. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Redon (Nuredin) Bajramit;
6. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Afrim (Zenel) Memetit, Jakup (Ejup) Ismailit, Bajram (Ibish) Gashit dhe Jahi (Mejdi) Ramadanit;
7. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Bahri (Rifat) Hoxhës dhe Besnik (Halit) Asllanit;
8. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Adem (Hazir) Berishës, Hetem (Hazir) Berishës, Fadil (Hazir) Berishës dhe Rrustem (Hazir) Berishës;
9. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Qamil (Ismet) Bullatovcit, Agron (Ismet) Bullatovcit, Bajram (Muharrem) Bullatovcit dhe Bujar (Muharrem) Bullatovcit;
10. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Besim( Lika) Namanit, Naim (Isa) Berishës, Idriz (Halit) Blakçorit, Arsim (Esat ) Blakçorit, Hajdin (Izmi) Berishës, Zenel (Izmi) Berishës, Zymer

(Izmi) Berishës, Ilmi (Izmi) Berishës, Shaqir (Salih) Eminit, Milot (Isuf) Berishës, Fitim (Izmi) Berishës, Hatixhe (Bajram) Oranit, Neron (Isuf) Berishës, Alban (Feri) Blakçorit, Florim (Omer) Gashit, Ilir (Omer) Gashit, Nazife (Bajram) Namanit dhe Shefkije (Bajram) Blakçorit;

11. Informatë për gjendjen në institucionet shëndetësore (QKMF, QMU, QMF);
12. Informatën lidhur me përgatitjet për fillimin e viti të ri shkollor 2023 -2024;
13. Propozim-vendim për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës.
14. Të ndryshme.

#### Pika e parë

Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së gjashtë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjes së gjashtë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa.

#### Pika e dytë

Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore "Pranvera shqiptare '81".

Lidhur me Propozim-vendimin për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore "Pranvera shqiptare '81", të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Florim Krasniqi, përfaqësues i drejtorisë së Urbanizmit, duke cekur se lokacioni për të cilin bëhet fjalë është në oborrin e Mensës së Studentëve, ndërsa sa i përket raportit të vlerësimit të këtij vendimi, nga Ministria është kthyer me kërkesë për tri pika.

Pika e tretë është inkorporuar në këtë arsyetim dhe me kohë e kemi dërguar tek Shërbimi i Kuvendit.

Sa i përket pikës së parë dhe pikës së dytë, në të cilën kërkohet që ky vendim apo arsyetimi të jetë në harmoni me dokumentet e planifikimit është e pamundur, për shkak se dokumentet e planifikimit të cilat i kemi aktualisht, nuk i kemi të parapërcaktuara këto lloj kategorish se ku duhet të vendosen. Ne edhe me dokumentet aktuale të cilat i kemi në proces tentojmë që në të ardhmen me i pasur parasysh këto kërkesa, mirëpo është pak paragjykuese se çfarë kërkesa do të vijë pas dy viteve dhe nuk mund ta paragjykojmë lokacionin se ku do të vendosen. Intervenimet i kemi bërë në arsyetim. Ekstrakti apo pjesa grafike nga Plani zhvillimor është inkorporuar në arsyetim dhe e kemi dërguar tek Shërbimi i Kuvendit.

**Leutrim Retkoceri** bëri të ditur se i ka parë disa shkresa që Ministria i ka kthyer, përafërsisht si kërkesë mund të qëndrojë, mirëpo mendoj që me bazimin e ndarjes së lokacionit me Planin rregullues se si është në fotografi apo foto të gjeoportalit, e lehtëson pak a shumë për Ministrinë dhe e tërheq vërejtjen që e ka dhënë kohë më parë. Përndryshe, është një aktivitet që është mbajtur për shënimin e kësaj date, Demonstratat e vitit 81. Aty kanë marrë pjesë shumë akterë publikë, kanë vendosur gurthemel, mirëpo çështja nuk ka vazhduar të zhvillohet, kështu që po shpresoj se do të kalojë si pikë dhe do të ketë përkrahje në seancë.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore "Pranvera shqiptare '81" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e tretë**

**Raporti i Kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronave komunale për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023.**

Lidhur me Raportin e Kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronave komunale për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Doruntinë Maloku.

Ajo tha se ky është raportimi i rregullt që kryetari e bën në bazë të Ligjit për dhënie në shfrytëzim, neni 22, pika 2, ku kërkohet që gjatë raportimeve të kryetarit për gjashtëmujorët e qeverisjes, të bëhet një raportim edhe për monitorimin e kontratave, të cilat janë për shfrytëzimin e pronës komunale, kështu që ky është njëri ndër raportimet e kryetarit.

Pra, kjo është një përbledhje e veprimeve që janë ndërmarrë gjatë këtyre muajve në lidhje me shfrytëzimin e pronës komunale dhe një informatë për të gjitha kontratat të cilat Komuna sot i ka me palët në raport me shfrytëzimin e pronës komunale.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Raporti i Kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronave komunale për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023 dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.**

#### **Pika e katërt**

**Propozim-vendimi për arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës për realizimin e projektit të ngrohjes diellore "Solar4Kosovo" dhe realizimin e projekteve që dalin nga marrëveshja për realizimin e projektit të ngrohjes diellore "Solar4Kosovo".**

Lidhur me Propozim-vendimin për arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës për realizimin e projektit të ngrohjes diellore "Solar4Kosovo" dhe realizimin e projekteve që dalin nga marrëveshja për realizimin e projektit të ngrohjes diellore "Solar4Kosovo", të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Doruntinë Maloku.

Ajo theksoi se bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës për realizimin e projektit të ngrohjes diellore "Solar4Kosovo" dhe realizimin e projekteve që dalin nga marrëveshja për realizimin e projektit të ngrohjes diellore "Solar4Kosovo" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### Pika e pestë

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Redon (Nuredin) Bajramit.

#### Pika e gjashtë

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Afrim (Zenel) Memetit, Jakup (Ejup) Ismailit, Bajram (Ibish) Gashit dhe Jahi (Mejdi) Ramadanit.

#### Pika e shtatë

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Bahri (Rifat) Hoxhës dhe Besnik (Halit) Asllanit.

#### Pika e tetë

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Adem (Hazir) Berishës, Hetem (Hazir) Berishës, Fadil (Hazir) Berishës dhe Rrustem (Hazir) Berishës.

#### Pika e nëntë

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Qamil (Ismet) Bullatovcit, Agron (Ismet) Bullatovcit, Bajram (Muharrem) Bullatovcit dhe Bujar (Muharrem) Bullatovcit.

#### Pika e dhjetë

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Besim( Lika) Namanit, Naim (Isa) Berishës, Idriz (Halit) Blakqorit, Arsim (Esat ) Blakqorit, Hajdin (Izmi) Berishës, Zenel (Izmi) Berishës, Zymer (Izmi) Berishës, Ilmi (Izmi) Berishës, Shaqir (Salih) Eminit, Milot (Isuf) Berishës, Fitim (Izmi) Berishës, Hatixhe (Bajram) Oranit, Neron (Isuf) Berishës, Alban (Feriz) Blakqorit, Florim (Omer) Gashit, Ilir (Omer) Gashit, Nazife (Bajram)Namanit dhe Shefkije (Bajram) Blakçorit.

Doruntinë Maloku, drejtore, tha se sa i përket pikave të këmbimeve, përveç pikës së shtatë "Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Shyhyrete (Fazli) Ramës dhe Flamur (Fehmi ) Ramës, që u tërhoq për shkak të gabimeve teknike të zyrtarëve të Drejtorisë së Pronës. Nga pika 5 deri në pikën 11,

të gjitha janë këmbime, kështu që për të gjitha po flas me radhë, në mënyrë që të mos zgjatemi shumë.

Sa i përket pikës 5 "Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Redon (Nuredin) Bajramit", ky është një këmbim që derivon nga vendimi i kushteve urbanistike, lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit. Drejtoria e Pronës e ka punuar lëndën dhe e ka sjellë në Kuvend si rezultat i asaj që e ka lëshuar Drejtoria e Urbanizmit. Sa i përket pikës së 6 "Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Afrim (Zenel) Memetit, Jakup (Ejup) Ismailit, Bajram (Ibish) Gashit dhe Jahi (Mejdi) Ramadanit", edhe kjo është e njëjtë me vendim të kushteve urbanistike. Me sa mbaj mend, edhe një pjesë e këtyre parcelave të cilat janë në këtë vendim, janë pranë rrugës "A".

Sa i përket pikës së 7-të "Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Bahri (Rifat) Hoxhës dhe Besnik (Halit) Asllanit, po ashtu është një këmbim i bërë në bazë të kushteve urbanistike.

Po ashtu, pika e 8-të "Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Adem (Hazir) Berishës, Hetem (Hazir) Berishës, Fadil (Hazir) Berishës dhe Rrustem (Hazir) Berishës.

Pika e 9 -të "Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Qamil (Ismet) Bullatovcit, Agron (Ismet) Bullatovcit, Bajram (Muhamarrem) Bullatovcit dhe Bujar (Muhamarrem) Bullatovcit. Edhe kjo është në kuadër të Planit rregullues "Muhaxhirët".

Pika e 10-të "Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Besim (Lika) Namanit, Naim (Isa) Berishës, Idriz (Halit) Blakçorit, Arsim (Esat) Blakçorit, Hajdin (Izmi) Berishës, Zenel (Izmi) Berishës, Zymer (Izmi) Berishës, Ilmi (Izmi) Berishës, Shaqir (Salih) Eminit, Milot (Isuf) Berishës, Fitim (Izmi) Berishës, Hatixhe (Bajram) Oranit, Neron (Isuf) Berishës, Alban (Feriz) Blakçorit, Florim (Omer) Gashit, Ilir (Omer) Gashit, Nazife (Bajram) Namanit dhe Shefkije (Bajram) Blakçorit. Ky është një këmbim që po ashtu është me një informatë nga Drejtoria e Urbanizmit, mirëpo që bie në trasenë e rrugës "A". Kjo është e gjitha sa i përket këmbimeve.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrahën pikat: e pestë, e gjashtë, e shtatë, e tetë, e nëntë dhe e dhjetë e këmbimeve dhe dërgohen në Kuvend për miratim.**

**Kryesuesi theksoi se sa i përket Informatës për gjendjen në institucionet shëndetësore (QKMF, QMU, QMF), drejtori Izet Sadiku, besoj se do e sjellë në mënyrë elektronike raportin dhe do e lexojë para anëtarëve të tjerë.**


Sa i përket Informatën lidhur me përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2023 -2024, ka të bëj me drejtoreshën Besiana Musmurati, e cila në mënyrë elektronik e ka dërguar informatën, të cilën tashmë e keni.

Sa i përket Propozim – vendimit për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, ka të bëj me vitin kalendarik 2023-2024, me kohëzgjatje 1 vjeçare, vazhdimin e mandatit, sipas asaj që e pamë kandidatët janë të njëjtë.

*Mbledhja përfundoi në orën 10:55.*

Procesmbajtësja:  
Shyhere Islami

Kryesues i Komitetit  
Pëllumb Bajçinovci



---

Faqe10nga10